VENDIM
Nr. 26, datë 21.1.2026

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS ITALIANE, LIDHUR ME BASHKËPUNIMIN NË FUSHËN E MBROJTJES

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Italiane, lidhur me bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS ITALIANE LIDHUR ME BASHKËPUNIMIN NË FUSHËN E MBROJTJES

PREAMBUL

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Italiane, në vijim individualisht të referuar si "Palë" dhe bashkërisht si "Palët",

Duke ripohuar marrëdhëniet e gjera dypalëshe ndërmjet tyre, sfidat e përbashkëta të sigurisë dhe përvojën e punës krah për krah njëra tjetrës, përfshirë pjesëmarrjen e Forcave të tyre të Armatosura në NATO dhe në formate të tjera shumëkombëshe;

Të gatshme të ndërtojnë dhe forcojnë lidhjet ekzistuese ndërmjet Forcave të tyre të Armatosura;

Duke pasur parasysh kontekstin e ri të sigurisë në Evropë dhe nevojën për të koordinuar më mirë përpjekjet e tyre për paqen dhe stabilitetin rajonal;

Të përkushtuara për të adresuar sfidat strategjike të sigurisë dhe për të promovuar paqen dhe sigurinë ndërkombëtare në kuadër të angazhimeve të tyre shumëpalëshe;

Duke njohur përfitimet e thellimit të bashkëpunimit ndërmjet Palëve, veçanërisht nëpërmjet zbatimit dhe respektimit të standardeve të NATO-s dhe objektivave të aftësive;

Të vetëdijshme se Aleatët e NATO-s duhet të përmirësojnë efektivitetin dhe efiçencën e përpjekjeve të tyre gjithëpërfshirëse në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, duke synuar zhvillimin e qasjeve të reja për bashkëpunim dypalësh dhe shumëpalësh në mbrojtje dhe siguri, përfshirë koordinimin, mbi baza vullnetare, të politikave dhe planeve të mbrojtjes, me qëllim sigurimin e aftësive efektive;

Duke marrë në konsideratë Traktatin e Atlantikut të Veriut, të nënshkruar në Uashington më 4 prill 1949; Marrëveshjen ndërmjet Palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut për Statusin e Forcave të tyre, të nënshkruar në Londër më 19 qershor 1951 (në vijim "NATO SOFA"); Kartën e Kombeve të Bashkuara, të nënshkruar në San Francisko më 26 qershor 1945; si dhe Marrëveshjen ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Italiane për Mbrojtjen e Ndërsjellë të Informacionit të Klasifikuar, të nënshkruar në Tiranë më 9 dhjetor 2014;

KANË RËNË DAKORD SI MË POSHTË:

NENI 1
PËRKUFIZIME

Termat e përdorur në këtë Marrëveshje do të kenë kuptimet e mëposhtme:

1. "Palë Dërguese" nënkupton Palën që dërgon personel, materiale dhe pajisje tek Pala Pritëse për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje;

2. "Palë Pritëse" nënkupton Palën që pret në territorin e saj personelin, materialet dhe pajisjet e Palës Dërguese, me qëllim zbatimin e kësaj Marrëveshjeje;

3. "Palë e Tretë" nënkupton çdo subjekt që nuk është Palë në këtë Marrëveshje;

4. "Personel" nënkupton anëtarët e Forcave të Armatosura dhe/ose personelin civil të secilës Palë, përfshirë anëtarët e familjes që i shoqërojnë dhe që konsiderohen pjesë e njësisë familjare, të cilët janë të përfshirë në veprimtaritë e zhvilluara në kuadër të kësaj Marrëveshjeje.

NENI 2
QËLLIMI DHE FUSHA E ZBATIMIT

1. Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është të sigurojë një kuadër për zhvillimin dhe forcimin e bashkëpunimit dypalësh dhe të marrëdhënieve ndërmjet Palëve në fushën e mbrojtjes, duke u mbështetur në bashkëpunimin ekzistues dhe duke synuar identifikimin e fushave të reja të bashkëpunimit me interes të përbashkët dhe përfitim të ndërsjellë.

2. Kjo Marrëveshje do të zbatohet në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe italian, si dhe me të drejtën ndërkombëtare të zbatueshme dhe, për Palën Italiane, me detyrimet që rrjedhin nga anëtarësimi i Italisë në Bashkimin Evropian.

NENI 3
QËLLIMET E BASHKËPUNIMIT

Palët, në bazë të konsultimeve të plota dhe të rregullta dhe pëlqimit të ndërsjellë, do të forcojnë bashkëpunimin e tyre dypalësh në fushën e mbrojtjes me qëllimet e mëposhtme:

a) të ruajnë paqen dhe sigurinë;

b) të promovojnë partneritetin dhe bashkëpunimin e tyre;

c) të ndërtojnë dhe forcojnë më tej marrëdhëniet ekzistuese në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, mirëkuptimin dhe besimin e krijuar tashmë ndërmjet tyre;

d) të identifikojnë, diskutojnë dhe synojnë arritjen e një mirëkuptimi të përbashkët mbi çështjet strategjike të mbrojtjes dhe sigurisë dhe t'i trajtojnë ato së bashku;

e) të përmirësojnë efektivitetin dhe efiçencën e politikave të tyre të mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura;

f) të zhvillojnë dhe forcojnë, sipas rastit, shkëmbimin e informacionit, njohurive dhe bashkëpunimin në nivel ekspertësh;

g) të forcojnë ndërveprueshmërinë dhe aftësinë për dislokim, si dhe të përmirësojnë kapacitetin e tyre për të vepruar bashkërisht në operacione ndërkombëtare;

h) të synojnë optimizimin e përdorimit të burimeve të tyre të mbrojtjes dhe të përmirësojnë efiçencën kosto-përfitim;

i) të arrijnë përfitime dhe efiçenca teknologjike, si dhe të zhvillojnë kapacitete që lidhen me prokurimin e mbrojtjes dhe mbështetjen e pajisjeve;

j) të promovojnë dhe forcojnë bashkëpunimin tregtar ndërmjet grupeve shtetërore dhe private të interesit të industrisë së mbrojtjes dhe kontraktorëve të rekomanduar dhe mbështetur nga Palët përkatëse.

NENI 4
FUSHAT E BASHKËPUNIMIT

1. Bashkëpunimi ndërmjet Palëve do të përfshijë fushat e mëposhtme:

a) trajnimin dhe arsimin ushtarak;

b) politikën e sigurisë dhe të mbrojtjes;

c) pjesëmarrjen e ndërsjellë në stërvitje/trajnime ose në veprimtari të përbashkëta stërvitore apo në cilësinë e vëzhguesit;

d) industrinë e mbrojtjes, duke përfshirë, por pa u kufizuar në zhvillimin e përbashkët të projekteve industriale, ndërtimin detar, transferimin e teknologjisë dhe bashkëpunimin në fushat e testimit teknik, vlerësimit dhe certifikimit të produkteve ushtarake;

e) infrastrukturën ushtarake;

f) procedurat e blerjes, prokurimit, menaxhimit dhe kontraktimit;

g) bashkëpunimin ushtarak dhe vizitat e kontakteve ndërmjet Forcave të Armatosura;

h) mjekësinë ushtarake dhe shërbimet shëndetësore;

i) fushat operacionale detare, tokësore, ajrore, hapësinore dhe hapësirës kibernetike;

j) bashkëpunimin logjistik, grantet dhe mbështetjen logjistike;

k) komunikimet, elektronikën dhe sistemet e informacionit;

l) veprimtaritë ushtarake, kulturore dhe sportive;

m) operacionet jashtë kontekstit të luftës, të tilla si operacionet paqeruajtëse, ndihmës humanitare dhe kundër piraterisë;

n) shkëmbimin e njohurive mbi sistemet ligjore ushtarake;

o) shkëmbimin e personelit për zhvillim profesional;

p) shkëmbimin e personelit dhe njësive ushtarake;

q) trajnimin dhe shkëmbimin e përvojave në kërkim dhe shpëtim;

r) historinë ushtarake;

s) çdo fushë tjetër që mund të bihet dakord nga Palët.

2. Për zbatimin e bashkëpunimit në kuadër të kësaj Marrëveshjeje, mund të lidhen, nëse është e nevojshme, marrëveshje të mëtejshme ekzekutive të posaçme ndërmjet Palëve ose rregullime ndërmjet Autoriteteve Kompetente, brenda kuadrit të kësaj Marrëveshjeje.

NENI 5
FORMAT E BASHKËPUNIMIT

Bashkëpunimi ndërmjet Palëve do të zbatohet në format e mëposhtme:

a) vizita pune/takime ndërmjet zyrtarëve të Palëve, si p.sh. bisedimet dypalëshe të shtabeve dhe takimet e ekspertëve;

b) vizita pune/takime ndërmjet grupeve të interesit të industrisë ushtarake të Palëve dhe subjekteve të mundshme për ndërmarrje të përbashkëta;

c) vizita të delegacioneve të personelit;

d) pjesëmarrje në ekspozita të pajisjeve dhe armatimeve ushtarake, stërvitje ushtarake, seminare dhe konferenca;

e) shkëmbim të personelit pedagogjik dhe trajnues, si dhe të studentëve nga institucione ushtarake;

f) shkëmbim trajnimesh për personelin ushtarak dhe civil, përfshirë trajnimin për operacionet paqeruajtëse;

g) forma të tjera bashkëpunimi në sektorin ushtarak për të cilat Palët mund të bien dakord.

NENI 6
AUTORITETET KOMPETENTE

Autoritetet kompetente për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje janë:

- për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë: Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë.
- për Qeverinë e Republikës Italiane: Ministria e Mbrojtjes e Republikës Italiane.

NENI 7
SIGURIA E INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR

1. Të gjitha aspektet që lidhen me sigurinë e informacionit të klasifikuar të krijuar, trajtuar ose shkëmbyer në kuadër të kësaj Marrëveshjeje do të rregullohen në përputhje me Marrëveshjen ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Italiane për Mbrojtjen e Ndërsjellë të Informacionit të Klasifikuar, të nënshkruar në Tiranë më 9 dhjetor 2014.

2. Akses në informacion do t'i jepet vetëm personelit që ka autorizimin përkatës të sigurisë dhe për të cilët vërtetohet parimi i "nevojës për të ditur".

3. Personeli i Palës Dërguese do të jetë i detyruar të respektojë rregulloret e sigurisë së Palës Pritëse në çdo kohë.

4. Në rast ndërprerjeje të kësaj Marrëveshjeje në përputhje me Nenin 16, dispozitat e Marrëveshjes të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, do të vazhdojnë të zbatohen për informacionin e klasifikuar të krijuar, trajtuar ose shkëmbyer në kuadër të kësaj Marrëveshjeje gjatë periudhës së vlefshmërisë së saj.

NENI 8
PRONËSIA INTELEKTUALE

Palët angazhohen të zbatojnë procedurat e nevojshme për garantimin e mbrojtjes së të drejtave të pronësisë intelektuale, përfshirë patentat që rrjedhin nga veprimtaritë e kryera sipas kësaj Marrëveshjeje, në përputhje me legjislacionet e tyre kombëtare përkatëse, me të drejtën ndërkombëtare të zbatueshme, si dhe për Palën Italiane, me detyrimet që burojnë nga anëtarësimi i saj në Bashkimin Evropian.

NENI 9
ÇËSHTJET LIGJORE

1. Ushtrimi i juridiksionit penal dhe/ose disiplinor do të kryhet në përputhje me Nenin VII të Marrëveshjes për Statusin e Forcave të NATO-s (NATO SOFA).

2. Anëtarët e Forcave të Armatosura të Palës Dërguese nuk do të kenë autoritet disiplinor mbi anëtarët e Forcave të Armatosura të Palës Pritëse, ashtu siç anëtarët e Forcave të Armatosura të Palës Pritëse nuk do të kenë autoritet disiplinor mbi anëtarët e Forcave të Armatosura të Palës Dërguese.

NENI 10
DËMSHPËRBLIMET DHE KËRKESAT PËR KOMPENSIM

Kërkesat për dëmshpërblim në rast lëndimi/plagosjeje, vdekjeje ose dëmesh ndaj pronës do të zgjidhen në përputhje me Nenin VIII të Marrëveshjes për Statusin e Forcave të NATO-s (NATO SOFA).

NENI 11
PRIVILEGJET DHE PËRJASHTIMET

Për të gjitha çështjet që lidhen me privilegjet dhe përjashtimet e personelit të Palës Dërguese, do të zbatohen dispozitat e përcaktuara në Marrëveshjen për Statusin e Forcave të NATO-s (NATO SOFA).

NENI 12
SHËRBIMET MJEKËSORE DHE ÇËSHTJET FINANCIARE

1. Personeli duhet të jetë në gjendje të mirë shëndetësore për të kryer çdo veprimtari në kuadër të kësaj Marrëveshjeje.
Pala Pritëse mund të kërkojë një raport mjekësor që vërteton se personeli është në gjendje të mirë shëndetësore.

2. Secila Palë do të jetë përgjegjëse për shpenzimet e veta të shkaktuara gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje dhe të çdo Marrëveshjeje Ekzekutive dhe rregullimi pasues, në lidhje me:

a) shpenzimet e udhëtimit, dietat, pagat, sigurimet për sëmundje dhe lëndime/plagosje, si dhe çdopagesë tjetër që i takon personelit të saj, sipas rregulloreve të veta;

b) shpenzimet mjekësore dhe dentare, si dhe ato që lidhen me largimin apo evakuimin e personelit të saj të sëmurë, të plagosur apo të ndjerë/të vdekur.

3. Pa cenuar dispozitat e shkronjës "b" më sipër, Pala Pritëse do të ofrojë trajtim urgjent mjekësor në institucionet shëndetësore të Forcave të saj të Armatosura për çdo personel të Palës Dërguese që mund të ketë nevojë për ndihmë mjekësore gjatë zbatimit të veprimtarive të bashkëpunimit dypalësh në kuadër të kësaj Marrëveshjeje dhe të çdo Marrëveshjeje Ekzekutive ose rregullimi pasues.

Kur të jetë e nevojshme, trajtimi mund të ofrohet edhe në institucione të tjera shëndetësore, me kusht që Pala Dërguese të mbulojë shpenzimet e veta.

4. Të gjitha veprimtaritë e kryera në bazë të kësaj Marrëveshjeje dhe të Marrëveshjeve Ekzekutive dhe rregullimeve pasuese do të jenë të kushtëzuara nga fondet e disponueshme të Palëve, në përputhje me buxhetet e tyre të zakonshme në dispozicion, pa asnjë kosto shtesë për buxhetet e shtetit të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Italisë.

NENI 13
PROCEDURAT DOGANORE DHE TË PASAPORTAVE

1. Për të gjitha çështjet që lidhen me rregullat e qëndrimit, doganave dhe pasaportave për personelin, do të zbatohen dispozitat e Marrëveshjes mbi Statusin e Forcave të NATO-s (NATO SOFA).

2. Për të gjitha çështjet që lidhen me rregullat e qëndrimit, doganave dhe pasaportave që nuk mbulohen nga Marrëveshja NATO SOFA ose nga ndonjë marrëveshje tjetër përkatëse, personeli do t'i nënshtrohet rregullave të Palës Pritëse.

NENI 14
MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

Mbrojtja e të dhënave personale përcaktohet në Shtojcën e bashkëlidhur kësaj Marrëveshjeje, e cila përbën pjesë integrale të saj.

NENI 15
ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Çdo mosmarrëveshje që lind nga interpretimi dhe/ose zbatimi i kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet me mirëkuptim nëpërmjet konsultimeve dhe negociatave të drejtpërdrejta ndërmjet Palëve. Palët nuk do t'ia referojnë asnjë mosmarrëveshje ndonjë pale të tretë, gjykate apo tribunali.

NENI 16
DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit me anë të të cilit Palët do të informojnë njëra-tjetrën për përmbushjen e kërkesave të tyre të brendshme ligjore përkatëse për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

2. Kjo Marrëveshje do të mbetet në fuqi për një periudhë të pacaktuar, përveç rasteve kur njëra nga Palët kërkon ndërprerjen e saj.

3. Palët mund të ndryshojnë këtë Marrëveshje në çdo kohë me shkrim, me pëlqim të ndërsjellë.
Marrëveshjet ndryshuese do të hyjnë në fuqi sipas të njëjtës procedurë të parashikuar në paragrafin 1 të këtij neni.

4. Secila Palë ka të drejtë të ndërpresë këtë Marrëveshje në çdo kohë, duke informuar me shkrim Palën tjetër me njoftim me shkrim.

Ndërprerja e Marrëveshjes do të hyjë në fuqi gjashtë (6) muaj pas datës së marrjes së njoftimit përkatës. Gjithashtu, Palët mund të bien dakord bashkërisht për ndërprerjen e saj në çdo kohë.

5. Ndërprerja e kësaj Marrëveshjeje nuk do të cenojë zbatimin e projekteve, programeve, veprimtarive dhe/ose kontratave në proces, të cilat mund të vazhdojnë deri në përfundimin e tyre, përveç nëse Palët bien ndryshe dakord.

NË DËSHMI SA MË SIPËR, të nënshkruarit, të autorizuar sipas rregullave për këtë qëllim, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Hartuar në ROMË, më 13.11.2025, në dy kopje origjinale, secila në gjuhët shqip, italisht dhe anglisht, ku të gjitha tekstet janë njëlloj autentikë. Në rast të ndonjë mospërputhjeje, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS ITALIANE

Shtojcë

Klauzolat mbi transferimin e të dhënave personale ndërmjet institucioneve kompetente, në bazë të Nenit 14 të Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Italiane për Bashkëpunimin në Fushën e Mbrojtjes

Duke pasur parasysh nenin 46 2 (a) të Rregullores (BE) 2016/679 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 27 prill 2016, *"Për mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe lëvizjen e lirë të tyre"* që shfuqizon Direktivën 95/46/KE (Rregullorja e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave – GDPR), si dhe nenin 29, Ligjit Nr 9887, date 10.03.2008 për Mbrojtjen e të dhënave Personale.

Çdo "Institucion Kompetent" i njërës prej Palëve (në vijim: Institucioni), sipas nenit 6.1 të Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Italiane mbi Bashkëpunimin në Fushën e Mbrojtjes (në vijim: Marrëveshja), do të zbatojë garancitë për transferimin e të dhënave personale drejt një Institucioni të Palës tjetër, siç përcaktohet në Klauzolat e kësaj Shtojce.

Këto garanci janë detyruese për Palët dhe kanë përparësi ndaj çdo kërkese që bien ë kundërshtim me to, të përfshirë në legjislacionet e tyre përkatëse.

I. Përkufizime

Për qëllimet e këtyre Klauzolave, zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

(a) **"të dhëna personale"**: çdo informacion që lidhet me një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm ("Subjekti i të Dhënave") sipas Marrëveshjes. Një person fizik është i identifikueshëm kur mund të identifikohet, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në veçanti duke iu referuar një identifikuesi të tillë si emri, numri i identifikimit, të dhënat e vendndodhjes, një identifikues në internet ose një ose më shumë faktorë specifikë për identitetin fizik, fiziologjik, gjenetik, mendor, ekonomik, kulturor ose shoqëror të atij personi fizik.

(b) **"të dhëna të kategorive të veçanta"**: të dhëna personale që zbulojnë origjinën racore ose etnike, bindjet politike, fetare ose filozofike, anëtarësinë në sindikata, të dhëna gjenetike ose biometrike me qëllim identifikimin unik të një personi fizik, si dhe të dhëna që lidhen me shëndetin, jetën seksuale ose orientimin seksual të një personi fizik.

(c) **"të dhëna mbi veprat penale"**: të dhëna personale që lidhen me dënime penale dhe vepra penale ose masa sigurie të lidhura me to.

(d) **"të dhëna personale të zakonshme"**: të dhëna personale të ndryshme nga të dhënat e kategorive të veçanta ose ato që lidhen me veprat penale.

(e) **"përpunim"**: çdo veprim ose grup veprimesh që kryhet mbi të dhënat personale ose grupet e të dhënave personale, pavarësisht nëse me mjete automatike apo jo, të tilla si mbledhja, regjistrimi, organizimi, strukturimi, ruajtja, përshtatja ose ndryshimi, rikuperimi, konsultimi, përdorimi, zbulimi me transmetim, shpërndarja ose vënia në

dispozicion në ndonjë mënyrë tjetër, përafrimi ose kombinimi, kufizimi, fshirja ose shkatërrimi.

(f) **"transferim"**: dërgimi i të dhënave personale nga një Institucion i njërës Palë tek një Institucion i Palës tjetër.

(g) **"komunikim i mëtejshëm"**: dërgimi i të dhënave personale nga një institucion marrës tek një institucion tjetër brenda të njëjtit shtet.

(h) **"transferim i mëtejshëm"**: dërgimi i të dhënave personale nga një institucion marrës tek një institucion i një shteti të tretë ose organizatë ndërkombëtare.

(i) **"profilizim"**: çdo formë e përpunimit automatik të të dhënave personale që konsiston në përdorimin e këtyre të dhënave për vlerësimin e disa aspekteve që lidhen me një person fizik.

(j) **"shkelje e të dhënave personale"**: shkelje e sigurisë që sjell shkatërrimin aksidental ose të paligjshëm, humbjen, ndryshimin, zbulimin ose aksesin e paautorizuar në të dhënat personale të transferuara, të ruajtura ose të përpunuara.

(k) **"kërkesa ligjore të zbatueshme":** kuadri ekzistues rregullator i zbatueshëm për çdo Institucion, përfshirë rregulloret për të dhënat personale.

(l) **"Autoritet Mbikëqyrës"**: Autoriteti i pavarur i ngritur nga Palët për të mbikëqyrur zbatimin e legjislacionit kombëtar për mbrojtjen e të dhënave personale [1].

(m) **"të drejtat e subjektit të të dhënave":**

(i) **"e drejtë për të marrë informacion"**: e drejta e një Subjekti të të Dhënave për të marrë informacion mbi përpunimin e të dhënave personale në lidhje me të, në një formë të përmbledhur, transparente, të kuptueshme dhe lehtësisht të aksesueshme.

(ii) **"e drejtë aksesi"**: e drejta e një Subjekti të të Dhënave për të marrë konfirmim nëse të dhënat personale në lidhje me të po përpunohen apo jo, dhe, sipas rastit, për të pasur akses në të dhënat e tij/saj personale dhe në informacionet mbi përpunimin që është duke u kryer.

(iii) **"e drejtë korrigjimi"**: e drejta e një Subjekti të të Dhënave për të kërkuar korrigjimin ose plotësimin e të dhënave personale të pasakta në lidhje me të, pa vonesë të pajustifikuar.

(iv) **"e drejtë e fshirjes"**: e drejta e një Subjekti të të Dhënave për të kërkuar fshirjen e të dhënave të tij ose të saj personale, kur këto të dhëna nuk janë më të nevojshme në raport me qëllimet për të cilat janë mbledhur ose ndryshe përpunuar, ose kur të dhënat

---

[1] Në Itali, Autoriteti Mbikëqyrës, sipas nenit 77 të Rregullores (BE) 2016/679 (GDPR), është Autoriteti Italian për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (Garante per la protezione dei dati personali), veprimtaria e të cilit rregullohet nga neni 140-bis dhe nenet pasuese të Kodit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (*Dekreti Legjislativ 196/2003* dhe ndryshimet dhe shtesat pasuese).
Në Shqipëeri, Autoriteti mbikqyrës ëeshtë Komisioneri për të drejtën e informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sipas Nenit 75, të Ligjit ligjit 124/2024"Për mbrojtjen e të dhënave personale", shpallur me dekretin nr. 5, datë 15.1.2025, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë.
Mekanizmat alternativë proceduralë duhet të jenë paraprakisht të miratuar nga Autoriteti Italian për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

janë mbledhur ose përpunuar në mënyrë të paligjshme, në përputhje me këto Klauzola dhe me kërkesat ligjore të zbatueshme.

(v) **"e drejtë për kundërshtim"**: e drejta e një Subjekti të të Dhënave për të kundërshtuar në çdo kohë, për arsye që lidhen me situatën e tij/saj të veçantë, përpunimin e të dhënave personale në lidhje me të, pa cenuar ekzistencën e arsyeve të ligjshme bindëse për përpunimin, të cilat kanë përparësi ndaj interesave të Subjektit të të Dhënave, përfshirë përgatitjen, ushtrimin ose mbrojtjen e pretendimeve ligjore në gjykatë.

(vi) **"e drejtë për kufizim përpunimi"**: e drejta e një Subjekti të të Dhënave për të siguruar kufizimin e përpunimit të të dhënave të tij ose të saj personale, kur këto të dhëna janë të pasakta, përpunimi është i paligjshëm, Institucioni nuk ka më nevojë për të dhënat për qëllimet për të cilat janë mbledhur ose kur Subjekti i të Dhënave ka paraqitur një kundërshtim që është ende në proces vlerësimi.

(vii) **"e drejtë për të mos iu nënshtruar vendimeve të automatizuara, përfshirë profilizimin"**: e drejta e një Subjekti të të Dhënave për të mos iu nënshtruar një vendimi të bazuar vetëm në përpunim automatik, përfshirë profilizimin, që prodhon efekte juridike në lidhje me të ose që në mënyrë të ngjashme ndikon ndjeshëm mbi të.

II. Fusha e Zbatimit

Këto Klauzola zbatohen për personelin ushtarak dhe civil të Palëve të përfshira në veprimtaritë e bashkëpunimit të listuara sipas neneve 3, 4 dhe 5 të Marrëveshjes.

Për zbatimin e këtyre veprimtarive, Institucionet do të shkëmbejnë të dhënat personale të mëposhtme që i përkasin Subjekteve të të Dhënave:

1.Të dhëna të zakonshme: të dhëna personale (emri dhe mbiemri, kombësia, vendi dhe data e lindjes, vendbanimi/adresa e banimit), të dhëna kontakti (telefon, email), të dhëna profesionale, certifikatë sigurie, si dhe të dhëna që lidhen me pjesëmarrjen në veprimtari të veçanta (vizita, takime, kurse trajnimi, stërvitje ushtarake, operacione humanitare dhe paqeruajtëse, bashkëpunim shkencor ose teknik, bashkëpunim tregtar ose prodhues, veprimtari sportive etj.);

2.Të dhëna të kategorive të veçanta: të dhëna që lidhen me gjendjen fizike dhe mendore, probleme shëndetësore, të dhëna biometrike etj;

3.Të dhëna mbi veprat penale: përfshirje e mundshme në çështje penale.

III. Garancitë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

1. Kufizimi i qëllimit

Të dhënat personale do të transferohen midis Institucioneve vetëm për qëllimet e listuara në paragrafin II.

Institucionet nuk do të komunikojnë apo transferojnë më tej të dhëna personale për qëllime të ndryshme nga ato sa më sipër, duke u siguruar që do të marrin garanci të duhura për të garantuar që çdo përpunim i mëtejshëm të kufizohet tek këto qëllime, duke pasur parasysh parashikimet në paragrafin III 6.

2. Cilësia dhe proporcionaliteti i të dhënave

Institucioni që kryen transferimin, do të transferojë vetëm ato të dhëna personale që janë të përshtatshme, relevante dhe të kufizuara në çka është e nevojshme për qëllimet, për të cilat transferohen dhe përpunohen më tej.

Transferimi i të dhënave të kategorive të veçanta ose të dhënave mbi veprat penale lejohet vetëm nëse është rreptësisht e nevojshme për arritjen e qëllimeve të Marrëveshjes.

Institucioni që kryen transferimin do të garantojë që, sipas njohurive të tij, të dhënat personale që transferon janë të sakta dhe, nëse është e nevojshme, të përditësuara.

Në rast se një Institucion konstaton se të dhënat personale të transferuara në një Institucion tjetër janë të pasakta, ai do ta njoftojë menjëherë Institucionin marrës, i cili do t'i korrigjojë të dhënat sipas nevojës.

3. Transparenca

Çdo Institucion do t'i japë Subjektit të të Dhënave informacion të përgjithshëm mbi:

(a) identitetin dhe të dhënat e kontaktit të Kontrolluesit të të Dhënave dhe, kur është e zbatueshme, të Zyrtarit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (DPO);

(b) qëllimin, bazën ligjore dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, duke përfshirë periudhën e ruajtjes së tyre;

(c) marrësit të cilëve mund t'u dërgohen këto të dhëna personale si komunikime ose transferime të mëtejshme, duke specifikuar garancitë dhe arsyet e dërgimit të të dhënave;

(d) të drejtat e Subjektit të të Dhënave sipas këtyre Klauzolave dhe kërkesave ligjore të zbatueshme, duke përfshirë modalitetet e ushtrimit të këtyre të drejtave;

(e) informacion mbi vonesat e mundshme ose kufizimet e zbatueshme që lidhen me ushtrimin e këtyre të drejtave;

(f) të drejtën për të paraqitur ankim pranë një Autoriteti Mbikëqyrës, duke specifikuar të dhënat përkatëse të kontaktit, si dhe të drejtën për t'iu drejtuar një Autoriteti Gjyqësor[2].

---

[2] Për sa i përket Italisë, Autoriteti Gjyqësor Kompetent, në bazë të nenit 79 të Rregullores së Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave (GDPR), është Gjykatësi i Zakonshëm, siç parashikohet në nenin 152 të Kodit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (Dekreti Legjislativ 196/2003, i ndryshuar dhe plotësuar).

Për sa i përket Republikës së Shqipërisë, bazuar në ligjin 124/2024"Për mbrojtjen e të dhënave personale""Autoritet kompetent" është gjykata, prokuroria dhe çdo organ publik, që ka në kompetencë parandalimin, hetimin, zbulimin ose ndjekjen e veprave penale, ose ekzekutimin e dënimeve penale, përfshirë mbrojtjen dhe parandalimin e kërcënimeve ndaj sigurisë publike, mbrojtjes ose sigurisë kombëtare, ose çdo institucion tjetër, të cilit i është dhënë me ligj e drejta

Çdo Institucion do të publikojë informacionin e përgjithshëm të mësipërm në faqen e tij zyrtare të internetit, së bashku me tekstin e Marrëveshjes.

Një kopje e informacionit të përgjithshëm, si dhe një referencë për faqen përkatëse të internetit, do të përfshihet gjithashtu në komunikimet individuale që i dërgohen Subjekteve të të Dhënave.

4. Siguria dhe konfidencialiteti

Çdo Institucion do të zbatojë masa të duhura teknike dhe organizative për të mbrojtur të dhënat personale të marra nga aksesi, shkatërrimi, humbja, ndryshimi ose zbulimi i paautorizuar, qoftë aksidental apo i paligjshëm.

Këto masa do të përfshijnë masa administrative, teknike dhe fizike të sigurisë, duke përfshirë klasifikimin e të dhënave personale si të dhëna të zakonshme, të dhëna të kategorive të veçanta dhe të dhëna mbi veprat penale; kufizimin e personave të autorizuar për të pasur akses në të dhëna personale; ruajtjen e sigurt të të dhënave personale, në varësi të llojit të tyre; zbatimin e politikave të brendshme për të garantuar që të dhënat personale ruhen në mënyrë të sigurt dhe konfidenciale, duke përfshirë teknikat e pseudonimizimit dhe enkriptimit.

Masat më të rrepta sigurie do të zbatohen për përpunimin e të dhënave të kategorive të veçanta dhe të dhënave mbi veprat penale, duke siguruar akses më selektiv dhe trajnim të posaçëm për operatorët.

Në rast se Institucioni marrës vihet në dijeni të një cenimi të të dhënave personale, ai do të njoftojë Institucionin që ka kryer transferimin brenda 48 orëve dhe do të ndërmarrë masa të arsyeshme dhe të duhura për të korrigjuar apo minimizuar efektet e mundshme negative për Subjektet e të Dhënave, duke përfshirë njoftimin e këtyre Subjekteve pa vonesë të pajustifikuar, nëse cenimi mund të paraqesë rrezik të lartë për të drejtat dhe liritë e tyre.

5. Modalitetet e ushtrimit të të drejtave

Çdo Institucion do të zbatojë masa të përshtatshme për të qenë në gjendje që, me kërkesë të një Subjekti të të Dhënave:

1.të konfirmojë nëse po përpunon apo jo të dhëna personale në lidhje me të dhe, nëse po, t'i ofrojë akses në këto të dhëna dhe informacion mbi përpunimin e tyre, përfshirë qëllimin e përpunimit, kategoritë e të dhënave të përfshira, origjinën dhe marrësit e të dhënave, periudhën e parashikuar të ruajtjes dhe mundësinë për të paraqitur ankim ose apel;

2.të identifikojë të gjitha të dhënat personale të kërkuesit që janë transferuar tek Institucioni tjetër në bazë të këtyre Klauzolave;

---

për të ushtruar funksione, detyra ose kompetenca publike, në bazë të legjislacionit në fuqi për një ose disa prej këtyre qëllimeve"

3.të ofrojë informacion të përgjithshëm edhe në faqen zyrtare të internetit, lidhur me garancitë që zbatohen për transferimin e të dhënave tek Institucioni tjetër.

Çdo Institucion do të veprojë në mënyrë të arsyeshme dhe brenda një afati të duhur për çdo kërkesë të Subjektit të të Dhënave për korrigjim, fshirje, kufizim të përpunimit, kundërshtim të përpunimit ose për ushtrimin e të drejtës së tij ose të saj për të mos iu nënshtruar vendimmarrjes së automatizuar.

Adresat postare ose elektronike për paraqitjen e kërkesave të mësipërme duhet të specifikohen në informacionin e përgjithshëm që u dërgohet Subjekteve të të Dhënave, në përputhje me paragrafin III 3 mbi transparencën.

Institucioni mund të marrë masa të duhura, për shembull,

> të kërkojë tarifë të arsyeshme për të mbuluar kostot administrative të kërkesës; ose të refuzojë veprimin ndaj saj, nëse kërkesa është haptazi e pabazuar ose e tepruar.

Çdo Institucion mund të përdorë procedura të automatizuara për të arritur më efektivisht qëllimet e tij, me kusht që të shpjegojë arsyet e përdorimit të tyre dhe të sigurojë informacion domethënës mbi logjikën e përdorur.

Në çdo rast, të marrë paraprakisht pëlqimin e qartë dhe të shprehur të Subjektit të të Dhënave, ose të garantojë të drejtën për të mos iu nënshtruar vendimmarrjes automatike.

Në çdo rast, Subjektet e të Dhënave kanë të drejtën të kërkojnë korrigjimin e informacionit të pasaktë ose të paplotë që i përket atyre dhe rishikimin e vendimeve të automatizuara nëpërmjet ndërhyrjes njerëzore.

Të drejtat e Subjekteve të të Dhënave mund të kufizohen, në masën që është e nevojshme dhe proporcionale në një shoqëri demokratike, për të mbrojtur objektiva të rëndësishme të interesit publik, të njohura nga Palët, në frymën e reciprocitetit, që është karakteristikë e bashkëpunimit ndërkombëtar.

Në këtë kuadër përfshihen mbrojtja e të drejtave dhe lirive të të tjerëve, siguria kombëtare dhe mbrojtja, parandalimi, hetimi, zbulimi dhe ndjekja penale e veprave penale, si dhe zbatimi i funksioneve të monitorimit, inspektimit apo rregullimit të lidhura, qoftë edhe rastësisht, me veprimtarinë ekzekutive dhe mbikëqyrëse të Institucioneve që veprojnë në ushtrimin e autoritetit zyrtar.

Këto kufizime, të cilat duhet të rregullohen me ligj, mund të mbeten në fuqi vetëm për aq kohë sa ekziston arsyeja që i ka diktuar ato.

6. Komunikimi ose transferimi i mëtejshëm i të dhënave personale

6.1. Komunikimi i mëtejshëm i të dhënave personale

Një Institucion marrës mund të kryejë komunikimin e mëtejshëm të të dhënave personale tek një tjetër Institucion të së njëjtës palë vetëm me miratim paraprak me shkrim nga Institucioni që ka kryer transferimin, dhe nëse Institucioni marrës ofron të njëjtat garanci të përcaktuara në këto Klauzola.

Në kërkesën me shkrim për autorizim, Institucioni marrës duhet të paraqesë informacion të mjaftueshëm mbi

- llojin e të dhënave që synon të komunikojë, Institucionin marrës, bazën ligjore, arsyet dhe qëllimin e komunikimit.

Përjashtimisht, një Institucion marrës mund të kryejë komunikim të mëtejshëm të të dhënave personale tek një tjetër Institucion të së njëjtës palë, pa miratim paraprak nga Institucioni që ka kryer transferimin, vetëm në rastet kur është e domosdoshme për një nga arsyet e mëposhtme:

-mbrojtjen e interesave jetësore të një Subjekti të Dhënash ose të një personi tjetër fizik;

-përcaktimin, ushtrimin ose mbrojtjen e një të drejte administrative apo gjyqësore;

-zhvillimin e hetimeve apo procedimeve penale që lidhen ngushtë me veprimtaritë për të cilat janë transferuar të dhënat.

Në rastet e mësipërme, Institucioni marrës duhet të njoftojë paraprakisht Institucionin që ka kryer transferimin, duke dhënë detaje mbi

- të dhënat e kërkuara, Institucionin kërkues dhe bazën ligjore përkatëse.

Nëse informimi paraprak mund të jetë në kundërshtim me detyrimin e konfidencialitetit, si p.sh. në rastin e hetimeve në vijim, Institucioni marrës duhet të informojë Institucionin që ka kryer transferimin për kryerjen e komunikimit të mëtejshëm sa më shpejt që të jetë e mundur.

Në këto raste, Institucioni që ka kryer transferimin duhet të mbajë shënim për njoftimet dhe t'ia komunikojë Autoritetit Mbikëqyrës përkatës në rast kërkese.

Institucioni marrës duhet të garantojë që komunikimi i mëtejshëm i të dhënave personale pa autorizim paraprak, të kufizohet sa më shumë që të jetë e mundur, në veçanti duke u mbështetur në përjashtimet dhe kufizimet e zbatueshme.

6.2. Transferimi i mëtejshëm i të dhënave personale

Një Institucion marrës mund të kryejë transferimin e mëtejshëm të të dhënave personale tek një tjetër Institucion të një shteti të tretë ose organizatë ndërkombëtare vetëm

- me miratim paraprak me shkrim nga Institucioni që ka kryer transferimin, dhe nëse
- Institucioni tjetër ofron të njëjtat garanci të përcaktuara në këto Klauzola.

Në kërkesën me shkrim për autorizim, Institucioni marrës duhet të paraqesë informacion të mjaftueshëm mbi llojin e të dhënave që synon të transferojë, Institucionin përfitues (në shtetin e tretë ose organizatën ndërkombëtare), bazën ligjore, arsyet dhe qëllimet e transferimit të mëtejshëm.

7. Kohëzgjatja e ruajtjes së të dhënave

Institucionet do të ruajnë të dhënat personale për aq kohë sa kërkohet nga rregulloret ligjore të zbatueshme, të cilat duhet të përcaktojnë një afat kohor që nuk e tejkalon masën e nevojshme dhe proporcionale në një shoqëri demokratike, në përputhje me qëllimet për të cilat të dhënat janë përpunuar.

8. Mbrojtja administrative dhe gjyqësore

Nëse një Subjekt i të Dhënave çmon se një Institucion nuk ka përmbushur garancitë e parashikuara në këto Klauzola, ose nëse të dhënat e tij personale janë përpunuar në mënyrë të paligjshme, ai ose ajo ka të drejtë të

- paraqesë një ankim pranë një Autoriteti Mbikëqyrës, dhe t'i drejtohet një Autoriteti Gjyqësor, në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm në juridiksionin ku ka ndodhur shkelja e pretenduar.

Gjithashtu, Subjekti i të Dhënave ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblim për çdo dëm të mundshëm të shkaktuar.

Në rast të një mosmarrëveshjeje ligjore ose ankimi të paraqitur nga Subjekti i të Dhënave ndaj Institucionit marrës ose ndaj të dy Institucioneve, lidhur me përpunimin e të dhënave të tij personale, Institucionet do të shkëmbejnë reciprokisht informacion mbi këto mosmarrëveshje ose ankime dhe do të përpiqen t'i zgjidhin ato në mënyrë miqësore dhe në kohë.

Nëse Subjekti i të Dhënave ngre një kundërshtim dhe Institucioni që ka kryer transferimin çmon se Institucioni marrës nuk ka vepruar në përputhje me garancitë e parashikuara në këto Klauzola, Institucioni që ka kryer transferimin do të pezullojë transferimin e mëtejshëm të të dhënave personale tek Institucioni marrës, derisa të çmojë se ky i fundit e ka zgjidhur çështjen në mënyrë të kënaqshme.

Institucioni që ka kryer transferimin, do të informojë Subjektin e të Dhënave dhe Autoritetin Mbikëqyrës për zhvillimin e ngjarjeve.

IV. Mbikëqyrja

1.Mbikëqyrja e jashtme e zbatimit të saktë të këtyre Klauzolave garantohet nga Autoritetet Mbikëqyrëse.

2.Çdo Institucion do të kryejë kontrolle të rregullta mbi politikat dhe procedurat e veta që lidhen me zbatimin e këtyre Klauzolave dhe efikasitetin e tyre.

Në përgjigje të një kërkese të arsyeshme nga një Institucion tjetër, Institucioni i kërkuar do të rishikojë politikat dhe procedurat e tij mbi përpunimin e të dhënave personale, me qëllim që të verifikojë dhe konfirmojë se garancitë e parashikuara në këto Klauzola janë zbatuar në mënyrë efektive. Rezultatet e rishikimit do t'i komunikohen Institucionit që ka kërkuar rishikimin

3.Nëse një Institucion marrës, për çfarëdo arsyeje, nuk mund të zbatojë në mënyrë efektive garancitë e parashikuara në këto Klauzola, ai duhet të informojë pa vonesë Institucionin që ka kryer transferimin.

Në këtë rast, Institucioni që ka kryer transferimin, do të pezullojë transferimin e të dhënave personale ndaj Institucionit marrës derisa të çmojë se ky i fundit e ka zgjidhur çështjen në mënyrë të kënaqshme.

Në këtë kuadër, si Institucioni që ka kryer transferimin, ashtu edhe Institucioni marrës do të informojnë Autoritetet e tyre Mbikëqyrëse përkatëse.

4.Nëse një Institucion që ka kryer transferimin, çmon se Institucioni marrës nuk ka vepruar në përputhje me garancitë e përcaktuara në këto Klauzola, ai do të pezullojë transferimin e të dhënave personale ndaj tij derisa të jetë i bindur se Institucioni marrës e ka zgjidhur çështjen në mënyrë të kënaqshme.

Në këtë kuadër, Institucioni që ka kryer transferimin, do të mbajë të informuar Autoritetin e tij Mbikëqyrës.

V. Rishikimi i këtyre Klauzolave

1.Palët mund të zhvillojnë konsultime për të rishikuar kushtet e këtyre Klauzolave në rast të një ndryshimi thelbësor në kërkesat ligjore të zbatueshme.
2.Ndryshimet do të hyjnë në fuqi sipas procedurës së përcaktuar në nenin 16 të Marrëveshjes.

3.Të gjitha të dhënat personale që janë transferuar tashmë në bazë të këtyre Klauzolave, do të vazhdojnë të përpunohen duke zbatuar garancitë e parashikuara në to.